EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8049
E enjte, 8 maj 2025
Çmimi 0. 50 €

NË PRISHTINË ËSHTË PËRURUAR LIBRI "USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS NË SHËNJESTËR TË VAZHDUESHME" I AUTORIT BARDHYL MAHMUTI

## Libër për të vërtetat e një epoke të luftës FAQE 6




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

# NGËRÇI NË KUVEND VAZHDON



Kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari, e ndërpreu sërish të mërkurën seancën për herë të 12. Ai njoftoi se ajo do të vazhdojë pas dy ditëve. Seanca dështoi pasi propozimi i kryesuesit, i cili vjen nga Lëvizja Vetëvendosje, nuk mori vota të mjaftueshme për të formuar një komision për votim të fshehtë për kryetarin e Kuvendit. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, tha pas seancës se zgjidhja e vetme për zhbllokimin e procesit të konstituimit të Kuvendit të Kosovës është ndërrimi i kandidates së propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, për pozitën e kryeparlamentares

## BARDUANI: KFOR-i S'ËSHTË I SHQETËSUAR NGA VAKUMI INSTITUCIONAL NË KOSOVË F. 3



## PE: KOSOVA TË BËJË REFORMA QË T'I AFROHET BE-SË, TË HAPË KAPITULL TË RI BISEDIMESH ME SERBINË F. 2



## AKTUALE



### KARDINALËT KATOLIKË MBLIDHEN NË VATIKAN PËR TA ZGJEDHUR PAPËN E RI F. 2

### OSMANI NDEROHET ME URDHRIN E FAMILJES MBRETËRORE "DATIN LAILA UTAMA" NGA SULLTANI I BRUNEIT DARUSSALAM F. 3

### KURTI BËRI HOMAZHE PRANË VARRIT TË HEROIT BAHRI FAZLIU F. 7

## EKONOMI



### 390.2 MILIONË EURO TË HYRA TATIMORE GJATË KATËR MUAJVE TË PARË TË 2025-s F. 8

### KRYETARI I AKB-së: KRIZA POLITIKE NË KULM, KOHA PËR NJË QEVERI TEKNIKE PA PARTI F. 8

## SPORT



### KOSOVA SYNON FITORE ISHUJVE FAROE F. 10

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# PE: Kosova të bëjë reforma që t’i afrohet BE-së, të hapë kapitull të ri bisedimesh me Serbinë

Prishtinë, 7 maj - Deputetët e Parlamentit Evropian kanë miratuar një raport për Kosovën që inkurajon shtetin të bëjë reforma për të lëvizur drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, po ashtu kanë kërkuar që Prishtina dhe Beogradi të hapin një kapitull të ri në bisedimet për normalizim.

“Është e qartë që procesi integrues i Kosovës ka nevojë për një momentum të ri - na duhet një kapitull i ri i bisedimeve në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Është jashtëzakonisht pozitive që të gjitha partitë e mëdha politike në Kosovë mbështesin fuqishëm integrimin në BE. E ardhmja e Kosovës është në familjen evropiane dhe ne do të punojmë së bashku në agjendën e reformave sepse çdo anëtarësim në të ardhmen duhet të bazohet në meritë”, tha raportuesi për Kosovën në PE, Riho Terras, raporton ‘Radio Evropa e Lirë’.

Sipas eurodeputetëve, dialogu për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, “fatkeqësisht nuk ka prodhuar rezultatet e pritura”, teksa u kërkuan të dyja palëve që t’i zbatojnë marrëveshjen e Brukselit dhe të Ohrit, përfshirë themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe që Serbia të mos kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në organizata rajonale dhe ndërkombëtare.

Për shkak të krizave në veriun e Kosovës, që rritën tensionet mes dy vendeve, që nga shtatori i vitit 2023 në Bruksel nuk është zhvilluar asnjë raund i dialogut politik, por ka pasur vetëm bisedime në nivel të kryenegociatorëve.

BE-ja ka përsëritur vazhdimisht se normalizimi i raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë është parakusht për rrugën e të dyja vendeve drejt integrimit evropian.



Së voni, shefja për politikë të jashtme dhe siguri e BE-së, Kaja Kallas, ka thënë se Brukseli është duke analizuar gabimet në procesin e dialogut, që ka nisur më 2011.

Ndërkaq, në raportin për Kosovë, PE-ja tha se shteti ka bërë përparim të dukshëm në reformën zgjedhore, qëndrueshmërinë ekonomike dhe mbrojtjen e të drejtave themelore. Megjithatë, sfidat mbeten sa iu përket reformave në gjyqësor, liri të medias, efikasitetit të administratës publike dhe digjitalizimit të shërbimeve publike. Eurodeputetët theksuan se përkushtimi i vazhdueshëm i reformave gjithëpërfshirëse dhe qeverisjes përfshirëse është thelbësore për përparimin e Kosovës në rrugën drejt integrimit evropian.

Eurodeputetët thanë, po ashtu, se Kosova ka qenë cak i ndërhyrjeve të huaja dhe fushatave dezinformuese, veçmas nga Rusia dhe Kina, që kishin për synim destabilizimin e rajonit dhe pengimin e integrimit evropian të Ballkanit perëndimor. Prandaj, “Parlamenti Evropian i bën thirrje Qeverisë së Kosovës t’i forcojë kapacitetet për t’i luftuar këto kërcënime”, tha PE-ja.

Më 7 maj eurodeputetët, po ashtu, kanë miratuar një raport për Serbinë, së cilës iu kërkua ta përmirësojë dialogun e brendshëm politik, ta mbrojë sundimin e ligjit dhe të bëjë reforma kundër korrupsionit.

Ndërkaq, a i përket dialogut me Kosovën, në raport u tha se Serbia “duhet të punojë për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse të normalizimit me Kosovën”, po ashtu edhe ta “harmonizojë plotësisht politikën e saj të jashtme me atë të BE-së”.

# Kardinalët katolikë mblidhen në Vatikan për ta zgjedhur papën e ri

Vatikan, 7 maj - Kardinalët katolikë romanë janë mbledhur të mërkurën për ta nisur detyrën e zgjedhjes së një pape të ri. Ata do të qëndrojnë të ngujuar larg botës derisa ta zgjedhin njeriun që shpresojnë se mund ta bashkojë një kishë botërore të larmishme, por të ndarë.

Në një ritual që ka rrënjët në mesjetë, kardinalët do të futen në Kapelën Sistine të Vatikanit, pas një meshe publike në Bazilikën e Shën Pjetrit dhe do ta nisin këshillin e fshehtë për ta zgjedhur pasardhësin e Papa Françeskut, i cili vdiq muajin e kaluar.

Asnjë papë nuk është zgjedhur në ditën e parë të këshillit, e njohur si konklava e fshehtë, prej shekujsh, prandaj votimi mund të vazhdojë për disa ditë para se ndonjëri nga princat me kapele të kuqe të kishës ta marrë shumicën e nevojshme prej dy të tretat e votave për t’u bërë papa i



267.

Të mërkurën do të ketë vetëm një votim. Në ditët në vijim, kardinalët mund të votojnë deri në katër herë brenda ditës.

Në fund ata i djegin fletët e votimit dhe, nëse nga oxhaku mbi çatinë e kapelës del tym i zi, nënkuptohet se papa i ri nuk është zgjedhur ende. Tymi i bardhë dhe kambanat që bien tregojnë se kisha me 1.4 miliard anëtarë ka një udhëheqës të ri.

Në meshën e mëngjesit të së mërkurës në Bazilikën e Shën Pjetrit, përpara hyrjes në konklavë, kardinalët u lutën që Zoti t’i ndihmojë ta gjejnë një papë që do të ushtrojë një “kujdes vigjilent” mbi botën.

Në predikimin e tij, kardinali italian Giovanni Battista Re u tha kolegëve të tij se duhet ta lënë mënjanë “çdo vlerësim personal” gjatë zgjedhjes së papës së ri dhe të kenë parasysh “vetëm të mirën e kishës dhe të njerëzimit”.

Re, dekan i Kolegjit të Kardinalëve, është 91 vjeç dhe nuk do të marrë pjesë në konklavë, sepse pjesë e saj mund të jenë vetëm kardinalët nën moshën 80-vjeçare.

Kardinalët gjatë ditëve të fundit kanë dhënë vlerësime të ndryshme për atë që kërkojnë te papa i ardhshëm.

Derisa disa kanë bërë thirrje për vazhdimësi me vizionin e Françeskut për më shumë reforma dhe të qenit të hapur, të tjerë kanë kërkuar rikthim te traditat e vjetra. Shumë kanë shprehur dëshirën për një papat më të parashikueshëm dhe të matur.

Një rekord prej 133 kardinalësh nga 70 vende do të hyjnë në Kapelën Sistine, në krahasim me 115 nga 48 vende në konklavën e vitit 2013 - një rritje që pasqyron përpjekjet e Françeskut për ta zgjeruar ndikimin e kishës në rajone të largëta me pak katolikë.

Ende nuk ka favorit të qartë, megjithëse kardinali italian Pietro Parolin dhe kardinali filipinas Luis Antonio Tagle konsiderohen ndër pretendentët kryesorë.

Ashtu si në kohët mesjetare, kardinalëve do t’u ndalohet komunikimi me botën e jashtme gjatë konklavës, dhe Vatikani ka ndërmarrë masa të teknologjisë së lartë për ta siguruar fshehtësinë, duke përfshirë pajisje që bllokojnë sinjalet për të parandaluar përgjimin.

Gjatësia mesatare e dhjetë konklavave të fundit ka qenë pak më shumë se tri ditë, dhe asnjë nuk ka zgjatur më shumë se pesë ditë. Konklava e vitit 2013 zgjati vetëm dy ditë.

Kardinalët do të përpiqen ta mbyllin procesin shpejt edhe këtë herë, për ta shmangur përshtypjen se janë të përçarë ose se kisha është pa udhëheqje.

## Schmidt në OKB: Bosnja është në krizën më të thellë që nga Marrëveshja e Dejtonit

Nju-Jork, 7 maj - Përfaqësuesi i Lartë ndërkombëtar në Bosnjë-Hercegovinë, Christian Schmidt, duke paraqitur raportin gjashtëmujor para Këshillit të Sigurimit të OKB-së mbi situatën në Bosnjë, theksoi se vendi ndodhet në një “krizë politike, por jo edhe të sigurisë”, dhe se “nuk ka rrezik për luftë”. Megjithatë, ai theksoi se situata në lidhje me Marrëveshjen e Dejtonit nuk ka qenë kurrë më e keqe dhe se gjithçka nisi pas aktgjykimit të shkallës së parë ndaj presidentit të entitetit serb të Bosnjës, Millorad Dodikut, që u përdor nga autoritetet e Republikës Sërpska si justifikim për hapa drejt “de facto shkëputjes”, përfshirë nismën për hartimin e një Kushtetute të re për entitetin serb. “Ky është kulmimi i politikave që janë zbatuar prej kohësh, për të cilat kam paralajmëruar edhe në raportet e mia të mëparshme”, tha Schmidt.

Ai shtoi se situata ekonomike po përmirësohet lehtësisht, por se vendi ndodhet në një krizë të thellë demografike.

Marrëveshja e paqes e Dejtonit, sipas tij, mbetet themeli mbi të cilin mund të ndërtohet e ardhmja e Bosnjë-Hercegovinës. Megjithatë, ai nënvizoi se kjo nuk nënkupton se nuk mund të diskutohen amendamente dhe ndryshime të nevojshme në Kushtetutën




shtetërore (e cila është pjesë e Marrëveshjes së Dejtonit).

Schmidt shtoi se para 30 vjetësh kur përfundoi lufta në Bosnjë, “askush nuk e kishte menduar se bashkësia ndërkombëtare do të ishte ende kaq e nevojshme edhe sot”. Duke e përmbyllur fjalimin, ai u bëri thirrje liderëve të vendit ta vazhdojnë rrugën drejt integrimeve evropiane, ndërsa bashkësinë ndërkombëtare e ftoi ta vazhdojë mbështetjen për vendin dhe qytetarët e Bosnjë-Hercegovinës, në mënyrë që ata “të mos harrohen”.

EPOKA E RE
Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# BARDUANI: KFOR-i S'ËSHTË I SHQETËSUAR NGA VAKUUMI INSTITUCIONAL NË KOSOVË




**Prishtinë, 7 maj** - Komandanti i misionit paqeruajtës të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë - KFOR, gjeneralmajor Enrico Barduani, ka deklaruar se, pavarësisht prej bllokadës politike që po vazhdon në Kosovë, KFOR-i nuk është i shqetësuar për ndonjë kërcënim të menjëhershëm ndaj sigurisë dhe mbetet plotësisht i përgatitur për t'u përballur me çdo përpjekje për destabilizim.

Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Barduani theksoi se periudhat zgjedhore mund të krijojnë hapësirë për aktorë të jashtëm me qëllime të këqija, por se KFOR-i e sheh situatën aktuale në Kosovë si pjesë të proceseve normale demokratike. "KFOR-i nuk është i shqetësuar", tha ai. "Jemi të pajisur mirë dhe të pozicionuar për t'u përballur me çdo kërcënim të mundshëm ndaj sigurisë".

Më shumë se një muaj pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 9 shkurtit, Kosova nuk ka arritur ende t'i formojë institucionet e reja.

Njëmbëdhjetë përpjekje për ta konstituuar Kuvendin e Kosovës dështuan, ndërsa në këtë situatë nuk mund të vazhdohet ende me formimin e qeverisë.

Duke folur për peizazhin më të gjerë të sigurisë, Barduani kujtoi dy incidente të mëdha në veri të Kosovës - sulmin e armatosur në Banjskë, në shtator të vitit 2023, dhe sulmin në kanalin ujor Ibër-Lepenc, në nëntor të 2024-s. Ai theksoi reagimin e shpejtë të NATO-s ndaj dhunës së vitit 2023, kur u vendosën edhe 1 000 trupa shtesë për ta forcuar praninë e KFOR-it, veçanërisht në veri. "Situata mbetet e qetë, por e ndjeshme ndaj përshkallëzimit të papritur", paralajmëroi Barduani, duke përmendur si shkak çështjet e pazgjidhura për shkak të mungesës së përparimit në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.

Për sulmin në kanalin e Ibër-Lepencit institucionet e Kosovës e akuzuan Serbinë si fajtore për incidentin, por kjo e fundit mohoi se ka gisht në këtë rast.

I pyetur për rrezikun e sulmeve të ardhshme, Barduani shmangu spekulimet, por theksoi gatishmërinë e vazhdueshme të KFOR-it. "Ne ruajmë një prani të shpejtë, fleksibile dhe të dukshme në të gjithë Kosovën, dhe jemi të gatshëm të veprojmë nëse është e nevojshme", tha ai.

Komandanti i KFOR-it vuri theks të veçantë në bashkëpunimin me Policinë e Kosovës dhe me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX). "Ne zhvillojmë patrullime të përbashkëta, ushtrime stërvitore dhe mbajmë kontakte të vazhdueshme", theksoi ai, dhe shtoi se komunikimi i shpejtë nga Policia e Kosovës gjatë operacioneve në veri është thelbësor për t'i shmangur keqkuptimet dhe përshk-allëzimet e panevojshme.

Marrëdhëniet me Forcat e Armatosura të Serbisë u përshkruan të qëndrueshme dhe transparente. Barduani konfirmoi takime të rregullta dhe komunikim të vazhdueshëm me udhëheqjen ushtarake serbe për ta siguruar vëzhgimin e aktiviteteve pranë vijës kufitare administrative. "Kemi çdo arsye për të pritur bashkëpunim të vazhdueshëm", tha ai, duke përmendur patrullimet e sinkronizuara dhe monitorimin e përbashkët si mjete kyçe për parandalimin e kontrabandës dhe forcimin e stabilitetit.

Pavarësisht prej pranisë së fuqishme ushtarake, Barduani përsëriti se paqja në Kosovë dhe në gjithë Ballkanin Perëndimor nuk mund të arrihet vetëm me mjete ushtarake. "KFOR-i dhe NATO-ja mund të bëjnë vetëm atë që është e mundur ushtarakisht. Zgjidhja afatgjatë është politike", theksoi ai, duke shprehur mbështetjen e plotë për dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Ai mirëpriti emërimin e përfaqësuesit të posaçëm të BE-së për dialogun, Peter Sorensen, me të cilin tashmë ka zhvilluar takime, duke konfirmuar mbështetjen e KFOR-it për përpjekjet diplomatike. "Për ta çuar përpara këtë dialog, të dyja palët duhet të tregojnë fleksibilitet, t'i bëjnë kompromiset e nevojshme dhe të përqendrohen te përfitimet afatgjatë", tha Barduani.

Duke folur për të ardhmen, Barduani vlerësoi bashkëpunimin e Kosovës me NATO-n dhe shprehu mbështetje për aspiratat euroatlantike të vendit. "I gjithë Ballkani Perëndimor duhet të ketë qasje në zonën euroatlantike si pjesë e Evropës", deklaroi ai, duke shtuar se: "Çelësi për zgjidhjen e çështjeve të mbetura në rajon është vullneti i të gjithë aktorëve për ta përqafuar diplomacinë, për ta refuzuar dhunën dhe për të punuar për kompromise".



# OSMANI NDEROHET ME URDHRIN E FAMILJES MBRETËRORE 'DATIN LAILA UTAMA' NGA SULLTANI I BRUNEIT DARUSSALAM

**Prishtinë, 7 maj** - Gjatë vizitës shtetërore në Sulltanatin e Bruneit Darussalam, presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, është nderuar me Urdhrin e Familjes Mbretërore Laila Utama, më i larti në nivel të shtetit. Ky urdhër u jepet tradicionalisht udhëheqësve të huaj ndërkombëtarë. Me këtë nderim presidentes Osmani i është dhënë gjithashtu edhe titulli honorifik "Datin Laila Utama", i cili bart një nder të veçantë në protokollin shtetëror të Bruneit.

Në ceremoninë e pranimit të këtij Urdhri dhe titulli, presidentja Osmani u shpreh se ky nder është simbol i fuqishëm i respektit të ndërsjellë dhe i miqësisë që po ndërtohet në mes dy popujve. "Ky Urdhër dhe ky titull nuk është vetëm një vlerësim për mua por, mbi të gjitha, një nderim për popullin e Kosovës. Jam thellësisht mirënjohëse për mikpritjen dhe respektin e treguar nga Sulltani dhe populli i Bruneit", ka theksuar Osmani.

Ky nderim i lartë është dëshmi e përkushtimit të presidentes Osmani ndaj forcimit të marrëdhënieve ndërshtetërore dhe promovimit të Kosovës në skenën ndërkombëtare.

Këtë Urdhër mbretëror dhe titull prestigjioz e ka marrë më parë edhe Mbretëresha Elizabeth II e Mbretërisë së Bashkuar.



# NGËRÇI NË KUVEND VAZHDON

**Kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari, e ndërpreu sërish të mërkurën seancën për herë të 12. Ai njoftoi se ajo do të vazhdojë pas dy ditëve. Seanca dështoi pasi propozimi i kryesuesit, i cili vjen nga Lëvizja Vetëvendosje, nuk mori vota të mjaftueshme për të formuar një komision për votim të fshehtë për kryetarin e Kuvendit. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, tha pas seancës se zgjidhja e vetme për zhbllokimin e procesit të konstituimit të Kuvendit të Kosovës është ndërrimi i kandidates së propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, për pozitën e kryeparlamentares**

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 7 maj** - Deputetët dështuan edhe në përpjekjen e 12 për ta konstituuar Kuvendin pas zgjedhjeve të 9 shkurtit. Procesi ka ngecur prej javësh pasi partia fituese, LV, nuk po arrin t'i sigurojë votat e nevojshme për kandidaten e saj për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu. Ajo shihet nga disa parti parlamentare si "figurë përçarëse", por LV-ja ngul këmbë se ajo është kandidate meritore.

Seanca dështoi për herë të 12 sepse nuk u votua një komision për votim të fshehtë për kryeparlamentar. Pro këtij komisioni votuan 56 deputetë, 1 kundër dhe nuk pati asnjë abstenim. "Seanca ndërpritet. Shihemi më 9 maj në orën 10:00", ka theksuar kryesuesi i seancës, deputeti Avni Dehari.

Kandidatja e Lëvizjes Vetëvendosje për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu, tha se nuk e kupton pse disa parti parlamentare nuk e pranojnë votimin e fshehtë për emërimin e saj. "Për mua është i paqartë qëndrimi i tyre për të mos marrë pjesë në votim për komisionin për votimin e kryetarit në mënyrë të fshehtë. Votimi i fshehtë është shumë demokratik për shumë pozita në Kosovë", tha Haxhiu.

Në lidhje me propozimin e liderit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, për qeveri tranzitore me të gjitha partitë parlamentare, Haxhiu tha se është e "papranueshme të injorohet vullneti i qytetarëve".

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Hekuran Murati, tha se propozimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për qeveri tranzitore gjithëpërfshirëse "nuk është serioz" dhe se nuk është opsion për Kosovën tani. "Në rastet kur ka luftë civile dhe vendi del nga lufta dhe nuk ka institucione, pra në raste të tilla kur ka kriza të papara, vendi mbetet pa qeveri dhe bëhet qeveri tranzitore. Kjo do të na kthente në vitin 2000", tha Murati. Ai shtoi se ky do të ishte një mesazh i keq për gjendjen në Kosovë te bashkësia ndërkombëtare. "Rezultati zgjedhor tashmë e ka përcaktuar se kush është fituesi dhe kush duhet ta udhëheqë qeverinë. Nëse nuk arrihet kjo në Kuvend, ne jemi të gatshëm të shkojmë në zgjedhje", shtoi ai.

Por, Murati tha se LV-ja nuk dëshiron që zgjedhjet e jashtëzakonshme të jenë opsion i parë, por opsion i fundit. "Vendi ka qeveri dhe po pret për një qeveri të re, për t'ia dorëzuar mandatin", tha Murati, duke shtuar se opsioni më i mirë për zgjidhjen e situatës do të ishte konstituimi i Kuvendit të Kosovës përmes votimit të fshehtë.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, tha se ai është i gatshëm të komunikojë "me të gjithë" për të gjetur një zgjidhje, si përgjigje në pyetjet për propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës që partitë politike shqiptare të bashkëpunojnë për qeveri tranzicioni. Megjithatë, ai tha se qëndrimin zyrtar të partisë do të mund ta japë vetëm pasi të mbahet një takim i kryesisë së PDK-së. Ai shtoi se zgjidhja e vetme për zhbllokimin e procesit të konsituimit të Kuvendit të Kosovës është ndërrimi i kandidates së propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, për pozitën e kryeparlamentares. "Kandidatja ka dështuar dhe do të dështojë sa herë që vjen [si propozim] në Kuvend", tha Krasniqi.

Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, tha se LDK-ja ende nuk ka marrë përgjigje zyrtare nga liderët e partive politike, përveç Ramush Haradinajt të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, lidhur me propozimin që të formohet një qeveri tranzitore gjithëpërfshirëse. Ajo tha se propozimi i LDK-së është "e vetmja zgjidhje për ta zhbllokuar procesin". "Nuk jemi të interesuar të kemi një qeveri me LV-në. I kemi ftuar të gjithë, i mirëpresim të gjithë. Nuk kemi vendosur asnjë kusht sepse gjithçka do të jetë subjekt i diskutimit të përbashkët", tha Bajrami.

Lidhur me deklaratën e Ganimete Musliut nga Partia Demokratike e Kosovës, se LDK-ja po frikësohet të marrë vendime politike, Bajrami tha se propozimi i LDK-së nuk tregon frikë, por konsistencë në qëndrime. "Besoj e dini të gjithë që në një opsion të tillë nëse LDK-ja do të ishte e interesuar për pozita dhe pushtet, do të ishte në pozitë shumë më të mirë po të bënte koalicion me LV-në", tha Bajrami.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se ai nuk do të pranonte të marrte pjesë në një takim konsultativ për qeveri tranzicionale nëse në tavolinë është edhe Lëvizja Vetëvendosje. "Ftesa për konsultë nuk ka gjë të keqe. Nuk ndryshon qëndrimi sa i përket qeverisë së opozitës, po ashtu nuk na pengon ftesa e LDK-së për konsulta", tha Haradinaj, duke iu referuar ftesës se një dite më parë të LDK-së që të gjitha partitë

# ABDIXHIKU: TË KËRKOSH UNITET POLITIK BRENDA SHQIPTARËVE NUK ËSHTË KRIM




**Prishtinë, 7 maj** - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se është për keqardhje për keqpërdorimin që po u bëhet disa partive minoritare mbi propozimin e tij të fundit për qeveri nacionale të tranzicionit. "Instrumentalizimi i tyre në përpjekjen e zgjidhjes politike e parlamentare, lë shenjë të rëndë në përfaqësimin e pakicave në Kosovë dhe marrëdhëniet e tyre me partitë shqiptare. Të painteresuar me përmbajtje por fatkeqësisht të interesuar në kopjimin e gjuhës fyese të polarizuesve, tre përfaqësues minoritarë, anëtarë të kabinetit qeveritarë në detyrë, mbajtën sot konferencë ku akuzuan LDK-në se nuk i ka përfshirë në propozimin tranzitor. Disa shkuan aq larg sa që për herë të parë në historinë e Republikës së Kosovës, e quajtën Lidhjen Demokratike - parti shoviniste. Ky qëndrim, kopjim i dëmshëm i urrejtjes së panevojshme, është instrumentalizim i ulët i përfaqësuesve të komuniteteve që sot duhet të kenë përfaqësim dinjitoz me të gjitha partitë parlamentare shqiptare", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Mbi të gjitha, ai ka thënë se të jesh shqiptar nuk është krim. "Të kërkosh bashkim ndërshqiptar nuk është krim. Të kërkosh unitet politik brenda shqiptarëve nuk është krim. Bashkëpunimi politik ndërshqiptar është mision politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës, që nga viti 1989 e deri më sot. Ç'është e vërteta, në 17 vite shtet, dakordimi mes partive shqiptare ka qenë parakusht i përfshirjes së mëpasshme minoritare; përfshirje e garantuar me Kushtetutë. Me Kushtetutën e hartuar nga LDK. Gjersa fatkeqësisht, për herë të parë në historinë shtetare, përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë mbajnë anë partiake. Jo vetëm anë, por renditen në vargun e gjatë të akuzave kundër një partie shqiptare, madje në këtë legjislacion, dhe ndaj vullnetit të shumicës parlamentare shqiptare të përfaqësuar me 52 deputetë", ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se një qasje e tillë është e dëmshme dhe për komunitetet joshumicë, dhe për demokracinë parlamentare.

"Për të gjithë me interes, sidomos për bashkëqytetarët tanë të nderuar nga komunitetet jo shumicë ja dhe teksti i plotë i letrës, që fatkeqësisht refuzohet të lexohet qëllimisht nga përfaqësuesit e juaj parlamnetar: 'Qeveria Nacionale e Tranzicionit, e formuar nga të gjitha partitë shqiptare dhe, në përputhje me dispozitat kushtetuese, edhe nga përfaqësues të partive të komuniteteve joshumicë, do të ketë afat të caktuar (deri në procesin e zgjedhjes së Presidentit të ri), qëllime të qarta politike dhe ekzekutive, program dhe agjendë ekzekutive të dakorduar, si dhe kryeministër dhe kabinet përfaqësues dhe unifikues'", ka shkruar Abdixhiku.

# ISH-DEPUTETI BERISHA: KOSOVA PO MBAHET PENG NGA EGOT PERSONALE




**Prishtinë, 7 maj** - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Hisen Berisha, ka komentuar moskonstituimin e Kuvendit. Ai ka thënë se po shohim një bllokadë të qëllimshme, zhargitje të proceseve kushtetuese dhe mungesë të thellë vullneti për dialog institucional. "Zgjedhjet e 9 shkurtit në Kosovë u shpalosën si një mundësi e artë për të rifilluar nga e para - me një mandat të ri, me përgjegjësi të reja dhe me pritje legjitime për ndryshim institucional. Por ajo që pasoi qe një vallëzim i mjerë politik, një sagë seancash të dështuara, lojërash të vogla pushteti dhe, mbi të gjitha, një rikthim alarmant i mendësisë moniste që e konsideron shtetin si pronë të pushtetit të radhës. Në vend të konstituimit dinjitoz të Kuvendit si shtyllë e sovranitetit popullor, kemi parë një bllokadë të qëllimshme, zhagitje të proceseve kushtetuese dhe një mungesë të thellë vullneti për dialog institucional. Asnjë seancë nuk solli zgjidhje; përkundrazi, secila tregoi sa e thellë është kriza e legjitimitetit, e bashkëpunimit politik dhe e respektit për rendin demokratik", ka shkruar ai në "Facebook".

Berisha ka theksuar se mungesa e konsensusit minimal për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, dështimi për ta ndërtuar shumicën qeverisëse dhe mospërfillja e zërit qytetar, e kanë paralizuar Kosovën në një moment vendimtar për të ardhmen e saj. "Përballë sfidave të mëdha ndërkombëtare dhe nevojës për një qeverisje të qëndrueshme, Kosova po mbahet peng nga egot personale, kalkulimet e vogla elektorale dhe një lidership politik që sillet si në kohën e partisë-shtet. Në vend të pluralizmit funksional dhe ndërtimit të institucioneve mbi dialog, po përballemi me një koncept autokratik të pushtetit, ku kompromisi shihet si dobësi, e ku çdo qëndrim ndryshe etiketohet si tradhti. Ky mentalitet e vret demokracinë nga brenda dhe e shtyn vendin drejt stagnimit institucional dhe izolimit ndërkombëtar. Kjo nuk është krizë vetëm politike por është krizë e vlerave dhe e vizionit", ka thënë ai.

Berisha ka pohuar se kur politika e sheh shtetin si arenë për dominim absolut, e jo si hapësirë për shërbim publik, atëherë pengohet zhvillimi, vdes shpresa dhe humbet besimi qytetar.

politike shqiptare të bashkëpunojnë për qeveri tranzicionale deri vitin e ardhshëm. Ai tha se do të pranonte takime bilaterale me LDK-në apo trilaterale me LDK-në dhe PDK-në.

Kryetari i Nismës, Fatmir Limaj, ka thënë se partia e tij parapëlqen qeveri të shumicës dhe se është e gatshme t'i përgjigjet ftesës së liderit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku. "Nëse kemi ftesë ne do të përgjigjemi për të shkuar dhe për ta dëgjuar. Ideja ime është një qeveri e shumicës", tha Limaj.

Limaj, partia e të cilit ka tri ulëse në Kuvend, tha se Kosova ka nevojë për qeveri të shumicës dhe se "kjo mund të ndodhë sepse ka potencial" për formimin e saj.

Elbert Krasniqi nga Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) e kritikoi ftesën e kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, që partitë politike shqiptare të bëhen bashkë për një qeveri tranzicionale. "Kjo qasje përjashtuese nuk është në frymën e Republikës së Kosovës, në frymën multietnike të Republikës së Kosovës", tha Krasniqi, përkrah Emilija Rexhepit, nga Partia e Re Demokratike, dhe Nenad Rashiqit, nga Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë.

Në konferencën e mbajtur një ditë më parë, Abdixhiku bëri ftesë që partitë politike shqiptare të bëjnë një qeveri tranzicionale, pa përmendur minoritetet. Por, në letrën e tij dërguar Albin Kurtit të LV-së, ai i përmend edhe pakicat, të cilat propozon të marrin pjesë "sipas dispozitave kushtetuese".

## Pse ka ngecur formimi i institucioneve edhe tre muaj pas zgjedhjeve?

Janë bërë pothuajse tre muaj nga zgjedhjet e 9 shkurtit dhe Kosova ende nuk i ka formuar institucionet e reja. Asnjë parti nuk e fitoi shumicën për të qeverisur e vetme. Lëvizja Vetëvendosje doli e para, me 48 ulëse. Procesi ka ngecur në konstituimin e Kuvendit, më saktësisht emërimin e kryetarit të Kuvendit. Seanca konstituive nisi më 15 prill dhe prej atëherë ka vazhduar 11 herë çdo të dytën ditë pas ndërprerjes. Vetëvendosja po dështon ta emërojë Albulena Haxhiun kryeparlamentare, pasi ajo ka marrë më së shumti 57 vota, 4 më pak se minimumi i nevojshëm për t'u zgjedhur. Së voni, kryesuesi i seancës konstituive, që vjen nga Vetëvendosja, ka kërkuar votim të fshehtë, por edhe ky propozim ka dështuar t'i marrë votat e nevojshme. Haxhiu nga disa parti parlamentare konsiderohet "figurë përçarëse", por Vetëvendosja ngul këmbë se ajo është kandidate meritore dhe nuk do të propozojë kandidat tjetër pavarësisht prej thirrjeve nga partitë e tjera për një kandidat "më unifikues".

NË PRISHTINË ËSHTË PËRURUAR LIBRI "USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS NË SHËNJESTËR TË VAZHDUESHME" I AUTORIT BARDHYL MAHMUTI

# LIBËR PËR TË VËRTETAT E NJË EPOKE TË LUFTËS







**Prishtinë, 7 maj** - Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" të mërkurën është bërë përurimi i librit "Ushtria Çlirimtare e Kosovës në shënjestër të vazhdueshme" i autorit Bardhyl Mahmuti. Në këtë përurim ishte i pranishëm edhe autori i librit, me të cilin u zhvillua bashkëbisedim për këtë libër dhe për tema me interes kombëtar.

Libri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës në shënjestër të vazhdueshme" i Bardhyl Mahmutit zbërthen manipulimet serbe për të zhdukurit dhe përpjekjet për kriminalizimin e luftës çlirimtare, tha ish-anëtar i Shtabit të Përgjithshëm i UÇK-së, Ramë Buja. "Kush dëshiron të mësojë të vërtetën lakuriqe për luftën në Kosovë duhet ta lexojë këtë libër. Është një mrekulli vërejtëse për kohën e një epoke të luftës. Ky libër vjen si një dhuratë fatsjellëse. Ka kaluar një kohë shumë e gjatë dhe është e vështirë të kujtohen ato ngjarje, sado që të kenë lënë gjurmë. Për të bërë të qartë se çfarë ndodhi në Kosovë, diçka që vështirë mund të mendohet e lëre më të realizohet. Në këtë libër zë vend serioz zgjerimi i manipulimit serb për të zhdukurit e luftës, gënjeshtra dhe manipulime që po vazhdojnë edhe sot në Gjykatën e Hagës. Edhe këtu bëhet një lojë. Ishte e ditur që nuk ishte ai synimi i ushtarëve të UÇK-së e assesi të merren me civilët serbë", tha Buja.

Historiani Genc Prelvukaj vlerësoi trajtimin shkencor të zhvillimeve politike e ushtarake, duke theksuar se libri demaskon dezinformimet dhe saktëson të vërtetat e shtrembëruara. "Trajtimi shkencor i zhvillimit politik dhe ushtarak nënkupton çështje komplekse. Ky botim vetëm i pasuron raftet e literaturës. Gjatë kohës janë bërë shumë punime, por deri tani në opinionin publik kanë qarkulluar vetëm informata sporadike, që më pas kanë ngatërruar gjithçka. Ky libër korrekton ato që janë thënë gabim. Në kuadër të veprës, autori bën denoncimin e pasaktësive. Janë hulumtuar rastet kur janë bërë sajime nga serbët për persona që nuk kanë qenë civilë. Në mënyrë të vëmendshme trajtohen rastet e vrasjeve dhe demaskohen të gjitha rastet. Pjesa më interesante ka të bëjë me sqarime duke dhënë argumente", tha Prelvukaj.

Autori i librit "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, në shënjestër të vazhdueshme", Bardhyl Mahmuti, tha se e ka ndier obligim moral t'i ndajë të vërtetat që i ka mbajtur për vete për dekada, duke u bërë thirrje shqiptarëve ta ruajnë kujtesën historike dhe të jenë mirënjohës ndaj atyre që kontribuuan për lirinë e Kosovës. "Kam qenë dëshmitar i drejtpërdrejtë dhe e kam parë të domosdoshme të nxjerr në opinionin publik atë që kam dashur ta mbaj me vete deri në botën tjetër. Pse kam dashur ta mbaj për vete? Dikur shqiptarët kanë qenë besnikë, por kishte zënë vend çështja se shqiptarët nuk e mbajnë fjalën. Duke parë interpretimet e asaj kohe, pas një çerek shekulli kam nxjerrë një pjesë ku kam qenë dëshmitar dhe kam folur në vetën e parë njëjës. Të gjitha takimet i kam biseduar. Thashë: është e domosdoshme t'i nxjerrim të gjitha ato për ata që u intereson e vërteta. Ne e kemi për obligim të vërtetën ta themi ashtu siç është. Kosova duhet të jetë mirënjohëse për çdo njeri që ka dhënë kontribut", tha autori i librit, Bardhyl Mahmuti.

# POLICIA ARRESTON NJË TË DYSHUAR NË VERI, I GJEN NJË PUNISHTE TË ARMËVE



**Mitrovicë, 7 maj** - Autoritetet e Kosovës kanë sekuestruar armë dhe kanë arrestuar një të dyshuar për importimin dhe eksportimin e armëve gjatë një bastisjeje në disa lokacione në veri të Kosovës, njoftoi të mërkurën Sistemi Prokurorial i Kosovës.

Policia ka gjetur një punishte të armëve në Mitrovicën e Veriut, e banuar me shumicë serbe, në të cilën ka sekuestruar "sasi armatimi, pjesë të ndryshme të armëve, makina që janë përdorur në ndërhyrje në armë", thuhet në njoftim.

Bastisjet u kryen nga Policia e Kosovës, Prokuroria Themelore në Mitrovicë dhe Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar në Prishtinë, me urdhër të gjykatës.

I dyshuari, identiteti i të cilit nuk është me dije, është dërguar në mbajtje dhe akuzohet për disa vepra penale, përfshirë importin, eksportin, furnizimin, transportimin, prodhimin, këmbimin, ndërmjetësimin ose shitjen të paautorizuar të armëve apo materieve plasëse, si dhe për armëmbajtje pa leje.

Autoritetet e sigurisë nuk dhanë më shumë hollësi në lidhje me atë se nga cilat vende apo se në cilat vendet mund të ketë importuar dhe eksportuar armë i dyshuari.

Në të kaluarën Policia e Kosovës ka gjetur dhe konfiskuar armatim kohë pas kohe, veçanërisht në veri të vendit. Në mars autoritetet i arrestuan 16 të dyshuar, përfshirë një zyrtar policor, për kontrabandë të armëve gjatë një operacioni të gjerë policor në jug dhe veri të Kosovës.

## Kurti bëri homazhe pranë varrit të heroit Bahri Fazliu



PRISHTINË, 7 MAJ - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, bashkë me ministrin në detyrë të Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, dhe deputetë të Kuvendit, bëri homazhe të mërkurën pranë varrit të heroit Bahri Fazliu, në varrezat e dëshmorëve në lagjen Velania.
Duke kujtuar dhe nderuar figurën e tij, kryeministri Kurti tha se Fazliu ishte një shembull i luftëtarit çlirimtar edhe para luftës çlirimtare. "Bashkë me anëtarët e familjes së respektuar Fazliu, e cila i dha dy dëshmorë të kombit dhe aq shumë kontribut për çlirimin, dhe me kolegë nga Qeveria e Republikës e Kuvendi i Kosovës, erdhëm sot në 27-vjetorin e rënies heroike të Bahri Fazliut, të bëjmë homazhe bashkë. Sepse Bahri Fazliu ishte shembull i luftëtarit çlirimtar edhe para luftës çlirimtare. Kemi pasur shumë veprimtarë të cilët e kanë përgatitur luftën, e në mesin e tyre ndër më të shquarit është Bahri Fazliu, që mbante pseudonimin 'Gëzimi'. Shkrimet e tij analitike, poezitë e tij romantike, atdhedashuria e tij e pafund dhe aksionet e betejat në të cilat mori pjesë, padyshim që e bëjnë atë një shembull të gjallë jo vetëm për brezin tonë, por edhe për gjeneratat që do të vijnë, se si duhet atdheu, si punohet për çlirim, si luftohet për bashkim. Lavdi Bahri Fazliut 'Gëzimit' dhe të gjithë dëshmorëve të kombit shqiptar!", ka theksuar kryeministri Kurti.

# HARADINAJ NDERON NJËRIN NGA FIGURAT MË TË RËNDËSISHME TË LUFTËS PËR LIRINË E KOSOVËS, BAHRI FAZLIUN



PRISHTINË, 7 MAJ - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, së bashku me bashkëpunëtorë, ka nderuar Bahri Fazliun në 27-vjetorin e rënies. "Në muajt e përvjetorëve të heronjve dhe dëshmorëve sot nderojmë njërin nga figurat më të rëndësishme të luftës për lirinë e Kosovës, Bahri Fazliun. Njeri i pushkës dhe i penës, trim, guximtar e i vendosur deri në vetëmohim, Bahriu fitoi përjetësinë 27 vjet më parë, duke u bërë shembull frymëzimi për rininë shqiptare se si duhet dashur atdheu dhe si sakrifikohet për të. Si Bahriu, edhe shumë të tjerë nga çdo cep i vendit, i dhanë shumë lirisë së Kosovës. Më 7 maj të vitit 1999, në Çabrat, heronjtë e Brigadës 137 'Gjakova' zhvilluan një nga betejat më të lavdishme të luftës sonë çlirimtare", ka thënë Haradinaj.
Haradinaj ka thënë se po në këtë datë ranë heroikisht: Gani Brahimaj nga Jabllanica, Françesko Xhyzepe Bider nga Biella e Italisë, Pjerë Arno Pajar nga Franca, Murad Muhamet Ali nga Algjeria, Nuhi Rrustem Berisha, Adnan Nexhmedin Krasniqi, Demush Isuf Lata, Demush Mavraj, Sinan Latif Berisha, Tomë Gjokaj, Hamdi Çetaj, Luan Krasniqi, Luan Smajli, Osman Tafa, Visar Juniku, Yllka Domi, Bujar Roka dhe Ahmet Xhikolli. "I dërrmuar nga humbjet në front, armiku u hakmor mbi civilët e pafajshëm. Në Gjakovë, te Ura e Taliqit, dhe në Ozdrim të Pejës, ku u ekzekutuan mizorisht 13 shqiptarë, një fshat që kishte qenë i përkushtuar ndaj lirisë që nga ditët e para të luftës. Përgjithmonë krenar me heronjtë tanë, me të rënët për liri dhe me rrugëtimin tonë për liri!", ka theksuar Haradinaj.

# UNIVERSITETI I PRISHTINËS NËNSHKRUAN MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN GAZI

PRISHTINË, 7 MAJ - Është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi në mes të Universitetit të Prishtinës dhe atij Gazi në Turqi. Nënshkrimet në dokumentin e përgatitur nga të dy universitetet i vunë rektorët, prof. Arben Hajrullahu dhe prof. Ugur Unal. Duke u dëshiruar mysafirëve të tij që në Kosovë të ndihen si në shtëpi, rektori i Universitetit të Prishtinës, Arben Hajrullahu, uroi "që marrëveshja të mos mbetet vetëm në letër, por të jetë shumë e gjallë dhe shumë aktive dhe këtë do ta bëjnë njerëzit e universitetit tuaj dhe tonit".
Rektori Ugur Unal u zotua se Universiteti Gazi do të ndajë me Universitetin e Prishtinës të gjithë përvojën teknologjike e profesionale që ka.
Memorandumi mbulon procedurat dhe parimet e bashkëpunimit akademik, kulturor e arsimor mes dy universiteteve.
Në takimin që i parapriu nënshkrimit dhe gjatë kësaj ceremonie solemne, rektorin Hajrullahu e shoqëruan edhe prorektorja për buxhet, financa dhe bashkëpunim me sektorin



publik e privat Albana Berisha-Qehaja dhe prorektori për kërkime shkencore, projekte dhe inovacion, Avni Hajdari, derisa nga Universiteti Gazi, përveç rektorit, erdhën edhe disa profesorë të Fakultetit të Edukimit në këtë institucion të arsimit të lartë.
Universiteti Gazi, i themeluar në vitin 1926 nga krijuesi i Turqisë Moderne Mustafa Kemal Ataturk, që nga ana e babait thuhet se ishte me origjinë shqiptare, e ka selinë në qendër të Ankarasë, është ndër universitetet më të mira në Turqi, ndërsa ofron, mes të tjerash, studime në fushat e teknologjisë, inxhinierisë, mjekësisë, edukimit, sportit dhe arkitekturës.

## Dërgohet një kontingjent i FSK-së në Shqipëri, në operacionin humanitar kërkim - shpëtim në "Qafën e Burrelit"



Prishtinë, 7 maj - Qeveria në detyrë ka zhvilluar mbledhje elektronike, në të cilën ka shqyrtuar dhe miratuar vendimin për aprovimin e kërkesës së Ministrisë së Mbrojtjes për dërgimin e Kontingjentit të FSK-së në operacion humanitar në Republikën e Shqipërisë.
Nga vendimi i kësaj mbledhjeje të 259 të qeverisë mjetet financiare për dërgimin e Kontingjentit të FSK-së në operacion humanitar sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.
"Ministria e Mbrojtjes, mbi bazën e objektivave dhe planifikimeve strategjike për zgjerimin e kapaciteteve dhe vënies në detyrë të këtyre kapaciteteve, është e përgatitur të mbështesë Shqipërinë me një kontingjent për nevojë humanitare, përkatësisht operacionin humanitar kërkim-shpëtim, në vendin e quajtur 'Qafë e Burrelit', Bashkia Klos. Kjo mbështetje është në kuadër të partneritetit strategjik me shtetet mike, në veçanti me Shqipërinë, me këtë rast për mbështetje të autoriteteve të shtetit shqiptar", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

## 390.2 milionë euro të hyra tatimore gjatë katër muajve të parë të 2025-s



**Prishtinë, 7 maj** - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka arritur të mbledhë gjithsej 390.2 milionë euro të hyra tatimore gjatë katër muajve të parë të vitit 2025, duke shënuar rritje të qëndrueshme prej 33.7 milionë eurosh apo 9.5 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo rritje e të hyrave tatimore është rezultat i drejtpërdrejtë i forcimit të transparencës institucionale, një komponent kyç që është vlerësuar edhe në raportet e fundit ndërkombëtare. Në këto raporte, ATK-ja është përmendur si një nga institucionet që ka shënuar përparim të dukshëm në ndërtimin e besimit ndërmjet saj dhe tatimpaguesve.

Për më tepër, ATK-ja ka njoftuar se kjo rritje e të hyrave është e lidhur ngushtë me uljen e evazionit tatimor. Çdo përmirësim në mbledhjen e të hyrave ka një ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e përmbushjes vullnetare dhe në reduktimin e ekonomisë joformale - një nga sfidat kryesore të sistemit tatimor.

Në këtë drejtim, ATK-ja vazhdon të fokusohet në përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave tatimore, duke e konsideruar këtë si mjetin më të fuqishëm për ta rritur përmbushjen e detyrimeve dhe për ta forcuar partneritetin me qytetarët dhe bizneset.

“Reformat në proceset operative, investimi në teknologji dhe digjitalizimi i shërbimeve tatimore kanë krijuar kushte më të avancuara për deklarimin dhe pagesën e tatimeve, duke e bërë sistemin më të drejtë, më efikas dhe më të qasshëm për të gjithë. Administrata Tatimore e Kosovës mbetet e përkushtuar që trendët pozitivë të performancës tatimore të kontribuojnë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe ofrim të shërbimeve më cilësore për tatimpaguesit e Republikës së Kosovës”, ka njoftuar ATK-ja.

# KURTI: BASHKË PËRKRAHIM RRITJEN E BIZNESEVE JO VETËM NË TREGUN E BRENDSHËM, POR EDHE NË TREGJET E MËDHA NDËRKOMBËTARE

EPOKA E RE Faton DËRMAKU




**Prishtinë, 7 maj** - Organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA), të mërkurën është mbajtur konferenca me titull “Roli i universiteteve në zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar”, në të cilën mori pjesë kryeministri në detyrë, Albin Kurti. “Universitetet hapin portat e dijes dhe ushqejnë shoqërinë tonë në krejt sferat, duke luajtur një rol të rëndësishëm në organizimin shoqëror, përpilimin e politikave dhe kërkimeve shkencore të cilat përdoren për ta rritur zhvillimin dhe për ta avancuar shoqërinë”, u shpreh kryeministri Kurti në fjalën e tij hyrëse.

Në këtë konferencë kryeministri foli edhe për mbështetjen nga ana e qeverisë, ku për herë të parë është aprovuar Projektligji për Zhvillim Rajonal të Balancuar, për zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm nëpër rajone. Me këtë rast, ai tregoi për miratimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025-2027, i cili parasheh një sërë veprimesh dhe aktivitetesh, e në kuadër të këtij programi, kryeministri përmendi skemën e dizajnuar nga qeveria për Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar, prej të cilit nga viti 2021 e deri në vitin 2024 janë përkrahur 901 projekte në vlerë rreth 7 milionë euro.

Ndër të tjera, sa i përket përkrahjes nga shteti, ai potencoi mbështetjen nëpërmjet masave siç është ajo e Pakos së Ringjalljes Ekonomike për mbështetjen e bizneseve për qasje në financa, mbështetje të bizneseve përmes subvencionimit të pagave të punëtorëve, skema e punësimit të garantuar “Qeveria për familjet”, shtesat për lehona dhe fëmijë, shtesat për punëtorët e sektorit privat e publik dhe pensionistë, subvencionimi i energjisë elektrike për familjet dhe bizneset, ndihma për familjet në asistencë sociale e rritja e mbështetjes për bujqësi.

“Bashkë prodhojmë, bashkë e nxisim produktivitetin, e përkrahim rritjen e bizneseve tona jo vetëm në tregun e brendshëm, por edhe në zgjerimin e aktivitetit të tyre duke depërtuar në tregjet e mëdha ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, në veçanti i kemi inkurajuar të rejat dhe të rinjtë, sipërmarrësit e rinj, bizneset e vogla e të mesme, për t’u rritur më tej e për të kontribuar pozitivisht në jetën ekonomike e në progresin shoqëror të vendit tonë.” tha ai.

Kryeministri Kurti e përmbylli fjalën e tij duke u uruar organizatorëve e pjesëmarrësve diskutime sa më të frytshme e produktive, gjersa kërkimi shkencor e karakteri hulumtues i universitetit dhe i studiuesve, në funksionim të mbarë e të mirë me institucionet vendore e qendrore, ka potencialin që të nxisë dije, të prodhojë ide dhe të njëjtat të jetësohen në praktikë përmes politikave të cilat i zhvillojnë rajonet, avancojnë shtetin dhe e rrisin mirëqenien e qytetarëve pa dallim.

## Kryetari i AKB-së: Kriza politike në kulm, koha për një qeveri teknike pa parti




**Prishtinë, 7 maj** - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka thënë se Kosova është futur në një krizë të thellë institucionale dhe politike të cilën partitë politike po e keqmenaxhojnë për interesa të ngushta e jo për të mirën e vendit. Ai ka thënë se dështimi për formimin e institucioneve pas zgjedhjeve, mosarritja e një marrëveshjeje për qeverisje dhe mungesa e përgjegjësisë politike, e kanë katandisur shtetin në një gjendje alarmi. “Në këtë situatë të rëndë, Aleanca Kosovare e Bizneseve, në emër të sektorit privat dhe të interesit publik, kërkon me urgjencë krijimin e Kuvendit të Kosovës dhe një qeverie teknike, jopartiake dhe profesionale, për të: 1. Rikthyer funksionimin e institucioneve kushtetuese dhe të Kuvendit; 2. Qeverisur në mënyrë neutrale dhe të përgjegjshme në një periudhë të përkohshme; 3. Trajtuar me prioritet krizën ekonomike, buxhetin publik dhe çështjet sociale; 4. Përgatitur vendin për një proces të ri zgjedhor ose një zgjidhje të qëndrueshme politike. Qytetarët janë të lodhur nga premtimet boshe dhe luftërat e brendshme politike që e kanë kapur shtetin. Kjo është një gjendje e papranueshme dhe e rrezikshme për stabilitetin e vendit. Mjaft më me bllokime, inate dhe kalkulime personale”, ka thënë Shahini.

Ai ka theksuar se qeveria teknike nuk është luks, por domosdoshmëri. “Është momenti që të gjithë ata që vërtet e duan Kosovën ta tregojnë me vepra, jo me fjalë. Aleanca Kosovare e Bizneseve është e gatshme të angazhohet aktivisht në këtë proces duke ofruar ekspertizë dhe lehtësim të dialogut politik e shoqëror, në funksion të interesit kombëtar dhe zhvillimit të qëndrueshëm”.

# ME DISHEPUJT E VOLTERIT: NUK KA NJË LIBRARI, SI AJO E LUMO SKENDOS...

Nga: Vedat KOKONA (1913-1998), pjesë nga kujtimet Endur me tisin e kohës

Në Tiranën e viteve tridhjetë, që kishte nja tridhjetë mijë banorë dhe jo peseqind e ca mijë si sot, kur shkonih e nuk shkonin nja katër karroca dhe ndonjë veturë në sheshin e bashkisë, kur dilnin vetëm dy gazeta të përditshme dhe një revistë në jave, kishte një librari, i zoti i së cilës ishte Mit'hat Frashëri, alias, Lumo Skendo, bir i Abdylit dhe nip i Samiut dhe i Naimit. Kur mendoj se sot, në Tiranën më gjysëm milion e ca banorë, të mijërave veturave që paradojnë në karuzelin e Sheshit Skëndërbej, ku botohen me dhjetra gazeta e revista në ditë, madje edhe pornoje dhe se nuk ka një librari si ajo e Lumo Skendos më shumë se gjysëm shekulli më parë, më hipën një valë hidhërimi që s'di si ta përcaktoj.

Ishte një librari e bukur, vendit të së cilës s'i ka mbetur as gjurma më e vogël; jo vetëm e asaj të parës të viteve '33 por as asaj që ishte në Rrugën Mbretnore, pranë Bela Venecias që më vonë u quajt Rruga e Barrikadave, dhe që sot dhe asaj i ka humbur vula. Sipas traditës së vendit tonë çdo gjë e bukur prishet dhe vendin e saj e zë e shëmtuara.

Që disa vjet më parë kisha dëgjuar emrin e Lumo Skendos, emrin e librit "Hi dhe shpuzë", që kishte botuar në fillimin e shekullit tonë, pastaj edhe nga babai që e kishte mik dhe që ishte pajtuar në revistën "Dituria" që botonte në Tiranë në vitet tridhjetë. Nuk e kisha parë kurrë në kafenetë Bela Venecia dhe Kursal të kryeqytetit, siç shihja qeveritarët dhe intelektualët e asaj kohe.

Lumo Skendon mund ta gjeje vetëm në Librarinë Lumo Skendo. Iu luta babait të më shpinte një ditë tek ai. Më shpuri. E gjetëm ulur përpara një tryeze të gjatë katërkëndëshe. Ajo që më ra në sy posa e pashë ishte jaka e ngritë e kollarisur, me dy cepa të ngritura siç e mbanin ata të shekullit XIX, kapaku i kollarisur i mëngës së këmishës që dilte nga xhaketa e kostumit krem shantung që binte menjëherë në sy nga pastërtia dhe pastaj ajo fytyrë që s'ishte si fytyra të tjera. Është e vërtetë se s'ka fytyrë të jetë si një tjetër, ashtu siç nuk ka edhe shenja gishtash që të jenë identike por, në përgjithësi, të gjitha fytyrat e njerëzve janë njësoj në vështrim të parë, të shpëlara, pa kolorit. Një fytyrë ndryshe nga të tjerat është ajo që godet menjëherë vështrimin si një rreze dielli. Ajo që më bëri përshtypje në fytyrën e thatë ishte shkëlqimi i syve. Thashë se ky njeri ishte ndryshe nga ata që kisha njohur deri atëhere, me përjashtim, sigurisht, të babait tim.

Ai sikur u gëzua – apo ashtu m'u duk mua – kur mësoi se studioja në Liceun e Korçës. Që atë ditë, sa kohë isha në Tiranë gjatë, kohës së pushimeve të verës, do veja shpesh në Librarinë e tij. Një ditë, iu luta t'i bëja vizitë në shtëpi, se kisha dëgjuar që kishte një bibliotekë shumë të pasur. Më ftoi më gjithë zemër. Vajta.

Më duket sikur e kam para syve edhe sot e kësaj ditë pas gjashtëdhjet vjetëve. Ishte një nga ato shtëpitë e vjetra tiranase, me dy kate me oborr të madh, në rrugën e Tenis Klubit. Kati i parë ku qëndruam, përbëhej nga një sallon i madh muret e të cilit ishin mbuluar me libra. U ulëm në dy karrige të vjetra përpara një tryeze të vogël vezake, ku ishin vendosur një filxhan kafeje me pjatë dhe një cigarishte. E dija që s'e pinte duhanin dhe ajo cigarishtja më tërhoqi vëmendjen.

– Po shikon cigarishten?

– Si urdhëron, i thashë me një zë pak të druajtur. Ju s'e pini duhanin?

– Kjo cigarishte dhe ky filxhan kafeje janë të Naimit.

M'u duk sikur isha në ëndërr. Kisha përpara meje cigarishten dhe filxhanin e kafesë të Naimit dhe, pranë meje, ja, këtu, nipin e Naimit, Mit'hat Frashërit! A kishte gjë më të bukur. Më bëri çaj, solli edhe kutinë e vogël me peta sheqeri.

– Sa peta?

– Tre.

– Jo, bir, çaji puhet me pak sheqer. Një petë e ke mjaft.

I kundërshtohesh Lumo Skendos? Kisha dëgjuar se ashtu e pinin dhe anglezët. Jo me një petë, po edhe pa sheqer fare e pija me ëndje atë çaj nga dora e tij!

– Mit'hat bej, pse nuk shkruani një monografi më të gjatë se ajo që keni shkruar për Naimin, sepse përveç jush, s'ka se kush ta shkruaj?

Mirë i thashë, më duket? Ç'mirë zeza! Se mos kishte nevojë ai për mendimin tim. Nuk më dha përgjigje. E kuptova që kisha nderur jashtë jorganit këmbët që m'u bënë akull: kisha lëshuar një notë të rreme në simfoninë e asaj pasdrekeje të bukur. I fola me admirim për librin e tij "Hi dhe shpuzë", për ato copa proze poetike që më pëlqenin aq shumë, për tregimin "Si vdiq Selman Todorusha", që i kisha lexuar që në moshën 14 vjeçare, për revistën "Dituria" që i vinte babait, me atë lëndë aq të pasur që, të them të drejtën, ishte pak e rëndë për stomakun tim, thesar i vërtetë kulturës sonë. Sikur u vrenjt pak, më hodhi një vështrim ku shprehej si një farë keqardhjeje për atë djalë të ri dhe tha: "Do t'ia kuptosh më vonë vlerën e vërtetë". Kishte shumë të drejtë. Si shumë gjërave, vonë, tepër vonë, ua kam çmuar vlerën, sepse gjatë jetës sime zhurma e daulleve dhe zurnave më ka penguar të dëgjoj fyellin magjik të artit. Një ditë e pyeta për shkrimtarët francezë, cili i pëlqente më shumë? Tjetër pyetje pa vend, për të mos thënë idiote. Se mos janë dy a tre që të zgjedhësh si ata dy a tre shkrimtarë që kemi ne?

U tregua i duruar më mua edhe i sjellshëm. Ishte shumë ironi, dishepull i Volterit dhe i Anatol Fransit dhe mund të më ngulte një thumb që ta mbaja mend tërë jetën.

– Anatol Fransi.

Nga ai kam edhe sot admirimin tim për autorin që më njohur me Silvestër Bonarin, që e kam lexuar më se dhjetë herë.

Një ditë, më fali një libër që i kishte pëlqyer shumë, "Un jardin sur l'Orente" (një kopësht në Orontë) të Moris Baresit, për të cilin më foli më pasion sidomos për prozën e magjishme. Iu zotova se, meqë i kishte pëlqyer, do ta përktheja. Më vështroi me një buzëqeshje të lehtë stërpikur me ironi: "Në arrifsh dot!" sikur donte të thoshte ajo buzëqeshje. Isha duke shkruar asi kohe disa poezi lirike dhe, me guximin e të riut, iu luta të më shkruante një parathënie. Prisja dhe isha i sigurt se do të merrja një përgjigje mohuese. Si u mendua pak, më tha:

– Kur e do?

M'u duk sikur isha bërë me fletë!

– Kur të doni ju, Mit'hat bej!

Kaloi java dhe parathënien e kisha në dorë. Në dorë! Përmbledhja e parë e vjershave të mia "Dritë dhe hije" me parathënien e Lumo Skendos! Mrekulli! Fluturova te Luarasi! Me këtë kaniks po nisesha për në dasmën e letërsisë …


Libraria LUMO SKENDO

Në doni libra, në ju pëlqen këndimi, në kini dëshirë për dijë, me një fjalë n' është se mëndja e juaj ka nevojë për ushqim DREJTOHUNI në librarinë Lumo Skendo, Ku do të gjeni një sasi të madhe veprash në çdo gjuhë: Letrature, diturije tekste shkollore.....

Porosit plotësohen me kujdes dhe shpejtësi të madhe

*Jo po në qoftë se nuk kini nevojë per ushqim të mendjes atëhere shkoni në..... Kafene!*


Mit'hat Frashëri alias Lumo Skendo, në librarinë e tij të famshme të viteve '30 të shekullit të kaluar









Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## FFK-ja organizon kursin e radhës për Licencën A për trajnerë



**Prishtinë, 7 maj** - Federata e Futbollit e Kosovës do ta organizojë kursin e trajnerëve për Licencën A. Kursi do të fillojë më 30 qershor dhe do ta përfshijë fazën e ligjëratave, punën praktike, monitorimeve në klube dhe atë të provimeve. Kriteret e pranimit në kurs janë: dëshmi mbi shkollimin (minimum diploma e shkollës së mesme), vërtetim nga policia rreth dosjes penale, certifikatë shëndetësore pranë QKMF-së, kopja e Licencës B, formular aplikimi. Kursi kërkon pjesëmarrjen aktive në teori dhe praktikë, gjithashtu trajnerët duhet ta përgatitin vetveten fizikisht për këtë kurs. Në fazën e fundit të kursit (në dhjetor 2025) kandidatët do t'i nënshtrohen provimit. Trajnerët të cilët i përfundojnë me sukses provimet do të marrin UEFA A-Licencë. Licenca A është kriter për licencën e ardhshme – UEFA Pro. "Trajnerët e interesuar janë të obliguar të aplikojnë online, ose t'i paraqesin dokumentet e nevojshme pranë zyrave të FFK-së deri më 6 qershor. Të gjitha aplikimet online ose informatat shtesë rreth kursit mund t'i merrni përmes email-it: departamentiteknik@ffk-kosova.com. Në total 24 do të jetë numri i të pranuarve në këtë kurs. Aplikimet e mëvonshme dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh", thuhet në njoftimin e FFK-së.

# Kosova synon fitore Ishujve Faroe

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 7 maj** - Kosova është përgatitur maksimalisht dhe e gatshme që sonte (e enjte) të shënojë fitore ndaj Ishujve Faroe, në ndeshjen e vlefshme për kualifikimet në "Euro 2026". Kjo ndeshje zhvillohet sonte në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve nga ora 20:15. Selektori i Kosovës, Bujar Qerimi, e pranon se kundërshtari është mjaft i fortë, por beson se sulmi i "dardanëve" do të funksionojë si duhet dhe ta thyejë mbrojtjen e Ishujve Faroe. "Atmosferën e kam gjetur të mirë në këtë grumbullim, sikurse që e kam lënë në grumbullimin e kaluar. Jemi përgatitur për përballjen me Ishujt Faroe. Kjo përballje është problematike për arsye se ata luajnë 60 minuta 7 me 6. Ne po punojmë që të gjejmë zgjedhjet sa më të mira për mbrojtjen e tyre dhe kemi fuqi në sulm dhe besoj se do t'ia dalim", ka thënë Qerimi.
Në kualifikime janë tetë grupe me nga katër ekipe kombëtare. Në Grupin 6 në vendin e parë është Kombëtarja e Ishujve Faroe me 5 pikë. Nga katër pikë i kanë Ukraina dhe Holanda, ndërsa Kosova i ka tri pikë. Në asnjë grup tjetër Kombëtarja e vendit të parë nuk i ka vetëm pesë pikë pas katër xhirosh. Dhe në asnjë grup tjetër Kombëtarja e fundit nuk i ka plot tri pikë. Po ashtu, në asnjërin prej shtatë grupeve të tjera diferenca prej të parit deri tek i katërti është vetëm dy pikë. Kjo dëshmon që grupi është plotësisht i hapur dy xhiro para fundit të kualifikimeve dhe njëkohësisht që grupi është më i forti i këtyre kualifikimeve. Ndërsa hendbollisti Haris Berisha ka




thënë se "dardanët" kanë treguar edhe në të kaluarën se mund të arrijë suksese ndaj kombëtareve të forta, prandaj presin edhe sonte ndaj Ishujve Faroe. "Të gjithë lojtarët janë të gatshëm për lojën kundër Ishujve Faroe dhe të fokusuar maksimalisht, pasi kjo lojë mund të na udhëheqë drejt kampionatit evropian. Nuk do të jetë aspak lehtë, por ne duhet ta japim maksimumin për ta arritur qëllimin. Edhe në të kaluarën ndaj kombëtareve të forta kemi treguar se mund të bëjmë lojë të mirë dhe të marrim rezultate pozitive. Njëjtë presim edhe në këtë ndeshje", ka thënë Berisha. Kosovës i duhet fitorja ndaj Ishujve Faroe për të mbetur fuqishëm në garë për kualifikim.

# Donjeta Sadiku dhe vëllezërit Bajoku përfaqësojnë Kosovën në Kupën Botërore 'Feliks Stamm'

**Prishtinë, 7 maj** - Federata e Boksit e Kosovës vazhdon të marrë pjesë në garat ndërkombëtare. Rrugëtimi i radhës është Kupa e Botës "Feliks Stamm", e cila mbahet nga 10 deri më 17 maj në Varshavë të Polonisë. Ekipi i Kosovës përfaqësohet me Donjeta Sadikun (60 kg), e cila do të udhëhiqet nga u. d. selektorja Marjola



Sallauka. Në konkurrencën e djemve marrin pjesë vëllezërit Bashkim Bajoku (55 kg) dhe Shpëtim Bajoku (70 kg), të cilët udhëhiqen nga selektori Faton Xhakli. Krahas medaljeve, turneu është i vlefshëm edhe për të fituar pikë për ranglistën ndërkombëtare. I ftuar nga Federata Botërore (World Boxing), për ta ndarë drejtësinë është edhe gjyqtari ndërkombëtar Latif Demolli.

# Broja nuk bën pjesë në planet e Evertonit

**Londër, 7 maj** - Armando Broja nuk do të jetë pjesë e skuadrës së Evertonit pas përfundimit të sezonit aktual. Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë në verë do të kthehet te Chelsea, pasi Evertoni nuk do ta shfrytëzojë opsionin e blerjes së tij. Broja ishte huazuar për një vit tek Evertoni nga Chelsea, por për shkak të lëndimeve të shumta nuk ka bindur me paraqitjet e tij. Në total, Broja ka 10 paraqitje këtë sezon në Premierë Ligë, kurse Evertoni



kishte të drejtën për ta blerë për 20 milionë euro. Broja ka kontratë me Chelsean deri në vitin 2028, kurse para Evertonit ka qenë i huazuar edhe te Fulhami e Southamptoni.

## Rrahani ishte shumë afër transferimit në Premierë Ligë

**Bukuresht, 7 maj** - Reprezentuesi Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Albion Rrahmani, shumë lehtë ka mundur të transferohet në Angli para se t'i bashkohej Spartës nga Praga. Një klub i Premierë Ligës i kishte bërë ofertë Rapid Bukureshtit për Rrahmanin dhe kishte negociuar për çmimin e tij. Këtë e kanë pranuar nga ekipi rumun, duke mos dashur ta përmendin emrin e skuadrës angleze, duke shtuar se Rrahmani ishte afër transferimit në Premierë Ligë. Në fund, duket se oferta e Spartës ishte më e mirë dhe Rrahmani në verën e vitit të shkuar u transferua në Çeki për 5 milionë euro. Rrahmani ishte pjesë e Rapidit gjatë sezonit 2023/24, në të cilin shënoi 19 gola në 30 paraqitje dhe ekipit rumun iu bashkua nga Ballkani i Suharekës. Në këtë sezon sulmuesi 24-vjeçar ka 9 gola e 3 asistime në 33 paraqitje për Spartën.



## Legjenda e Spartakut: Daku do t'i shërbente secilit klub të Moskës

**Moskë, 7 maj** - Ish-futbollisti i përfaqësueses së Rusisë dhe legjenda e Spartakut të Moskës, Aleksandër Mostovoi, ka vlerësuar sulmuesin shqiptar Mirlind Daku, duke thënë se ai do t'i shërbente çdo klubi të madh të Moskës. Në një intervistë për "RB Sport", Mostovoi u shpreh se Daku ka profilin dhe cilësitë për të qenë i suksesshëm te CSKA, Spartak, Dinamo apo Lokomotiva, klube këto të cilat janë të vendosura në Moskë. 27-vjeçari aktualisht luan për Rubin Kazanin dhe gjatë merkatos së janarit pati interes nga Spartaku dhe Lokomotiva, por ai vendosi të qëndrojë në Kazan deri në fund të sezonit. "Zeniti me shumë gjasë nuk do të interesohet për Dakun këtë verë, sepse ka një sulm të kompletuar. Te Krasnodari, Kordoba është më i fortë se Mirlindi, kështu që as ai nuk është opsion. Vetë Daku nuk do të dëshironte të ulej në stol nëse merret, duhet të jetë si titullar", u shpreh Mostovoi. Edhe pse Rubini mund të jetë një ambient i përshtatshëm për të, Mostovoi mendon se një hap drejt një klubi më të madh në Moskë do të ishte i dobishëm për Mirlind Dakun, duke parë potencialin e tij. "Nëse CSKA, Spartaku, Dinamo apo Lokomotiva e duan me të vërtetë, Daku duhet të shkojë atje", ka përfunduar ish-lojtari i Spartakut, Benficës dhe Celta Vigos.



# Në Inter nuk i fshehin emocionet: Ndeshje epike, tani duam trofeun

**Milano, 7 maj** - Me Inzaghin në stol, Interi "fluturon" për herë të dytë në tre vitet e fundit në finalen e Ligës së Kampionëve, pasi eliminoi Barçën në një ndeshje epike ku emocionet ishin jashtëzakonisht të forta. E përjetoi çdo sekondë edhe Inzaghi në stol, por si një kavalier i vërtetë fjalët e para ia rezervoi Barçës: "Më duhet t'i bëj komplimente Barcelonës pasi është skuadër shumë e fortë, më pas më duhet të duartrokas për djemtë e mi, që në dy ndeshje kanë zhvilluar paraqitje të jashtëzakonshme. Jam shumë krenar që jam trajneri i tyre. Kishim disa probleme, por me zemër dhe kurajë kaluam çdo pengesë. Ne e luajtëm këtë ndeshje me ato cilësi që kemi, e njihnim Barcelonën, e dinim se çfarë na priste, ishte e pamundur të kalonim më tej nëse nuk do të kishim sakrifikuar të gjithë së bashku. Flitet shumë për Yamal, por mua më la pa fjalë De Jong". Nuk ishte më i miri, por Lautaro Martinez sakrifikoi shumë për të qenë në fushë, jo vetëm që ia doli, por ishte dhe një nga protagonistët kryesorë. "Isha në vështirësi. Kam qarë gjatë gjithë javës pasi nuk isha në gjendjen që dëshiroja, por në fund ia dola të isha në fushë. Luajtëm kundër një skuadre të fortë, por Interi çdo vit rrit nivelin. Duhet të jemi krenarë. Që nga dita e parë pasi humbëm finalen kemi punuar për ta fituar. Kemi një shans të madh për ta shkruar historinë e klubit", u shpreh Lautaro.



Një tjetër protagonist i madh i këtij suksesi zikaltër ishte edhe Davide Frattesi, autori i golit të katër dhe të fitores. Mesfushori azzurr dukshëm u shfaq i kënaqur pas këtij suksesi: "Nuk e di, jam me fat që e mbyll ndeshjen pasi më merren mend. Kemi bërë një punë të jashtëzakonshme. Nuk di çfarë të them. Përjetova një emocion të fortë pas atij goli. Mbase nuk jam një lojtar me shumë talent, por jam i fundit që dorëzohet".

# Indiana vazhdon me befasi, Golden State fiton ndaj Minnesotas

**Indianapolis, 7 maj** - Indiana Pacers ka marrë një epërsi 2-0 në serinë çerekfinale të "play-off"-it të NBA-s kundër Cleveland Cavaliers, pasi fitoi një ndeshje dramatike si mysafir me rezultat 120:119. Clevelandi e nisi fuqishëm ndeshjen, duke arritur një epërsi prej 18 pikësh dhe duke e mbyllur çerekun e parë me avantazh të thellë, 32:15. Megjithatë, Pacersi reagoi në pjesën e dytë dhe ngushtoi diferencën, duke shkuar në pushim me vetëm 11 pikë disavantazh. Në çerekun e tretë, Cavaliersi arriti ta zgjerojë avantazhin, por fundi i ndeshjes i takoi plotësisht Pacersit. Në minutën e fundit realizoi një seri vendimtare prej tetë pikësh. Koshin e fitores e shënoi Tyrese Haliburton me një treshe spektakolare: pas një gjuajtjeje të lirë të humbur, ai siguroi topin në kërcim ofensivë, depërtoi me driblim dhe realizoi gjuajtjen vendimtare nga distanca. Aaron Nesmith dhe Myles Turner ishin më të mirët për Pacersin, me nga 23 pikë secili. Në anën tjetër, 48 pikët e jashtëzakonshme të Donovan Mitchellit për Cavaliersin nuk mjaftuan për fitore. Seria tani zhvendoset në Indianapolis për ndeshjen e tretë, e cila është planifikuar të luhet të shtunën. Ndërkohë, në ndeshjen tjetër çerekfinale të mbrëmjes, Minnesota Timberwolves u mposht nga Golden State Warriorsi me rezultat 99:88, me GSW që merr avantazhin 0-1 dhe epërsinë e terrenit vendas.



## SHKURT

### Yamal: Do ta sjell Ligën e Kampionëve në Barcelonë

Pas eliminimit të Barcelonës nga Liga e Kampionëve, talenti Lamine Yamal publikoi një mesazh premtues për tifozët në "Instagram", ku bëri një premtim se do ta sjellë trofeun e Ligës së Kampionëve në Barcelonë. "Dhamë gjithçka. Këtë vit nuk ishte e mundur, por do të rikthehemi. Mos dyshoni aspak. Nuk do të ndalemi derisa ta çojmë këtë klub atje ku e meriton, në majë. Do ta mbaj premtimin tim dhe do ta sjell Ligën e Kampionëve në Barcelonë. Por të dielën kemi një tjetër finale. Duhet të jemi të gjithë bashkë. 'Visca el Barça'!", ka shkruar Yamal.

### Vasseur: Hamiltoni duhet të ketë besim tek unë

Gara e fundit e Formulës 1 zhvilluar në Majemi tregoi se Ferrari është shumë larg pritshmërive. Jo vetëm kaq, por pilotët po tregohen të paduruar dhe po debatojnë mes tyre dhe drejtuesve, duke nisur një krisje. Ai që kërkohet të vendosë qetësi te "kokëkuqja" është shefi Frederic Vasseur, që pas garës amerikane ka pasur një takim "kokë më kokë" me shtatë herë kampionin e botës, Lewis Hamilton. Përmbajtja e bisedës u zbulua nga vetë francezi. "Shqetësimi im nuk ishte se ai duhej të fliste me mediet. Përkundrazi, midis nesh duhet të jemi të qartë se në këtë situatë ai duhet ta kuptojë pozicionin tim", ka thënë shefi i Ferrarit. "Ai duhet të më besojë mua, unë mund t'i besoj atij. E njëjta gjë vlen edhe për Charlesin. Kur marr një vendim, e marr për Ferrarin", ka shtuar Vasseur.

### 'Marca' voton për 'Topin e Artë': Po sikur të jetë radha e Sommer?

Në një ndeshje të mbushur me çaste të paharrueshme dhe heronj të shumtë, nga goli i çmendur i Acerbit, te sakrifica e Thuramit e zemra e Lautaros, për shumëkënd, protagonisti absolut i spektaklit epik në mes të Interit dhe Barcelonës ishte vetëm një: Yann Sommer. Portieri 36-vjeçar zviceran kreu një sërë pritjesh spektakolare që i hapën Interit rrugën drejt finales në Munih. Ajo më e bujshmja, në fund të ndeshjes, ndaj goditjes së majtë të Lamine Yamal, duke lënë pa fjalë gjithë "San Sironi". Një tjetër pritje e pabesueshme erdhi ndaj Eric Garcias, në një situatë me portën thuajse bosh. Për "Marca"-n këto janë ndërhyrje që, nëse finalja përfundon me fitoren e Interit, mund t'i hapin rrugë një ëndrre të papritur: Topi i Artë për Yann Sommer. Në një vit pa një favorit të qartë, pyet gazeta spanjolle, a ka ardhur momenti që një portier ta rrëmbejë çmimin më të madh individual? Deri më tani vetëm legjenda sovjetike Lev Yashin ka fituar "Topin e Artë" si portier. Të tjerë të mëdhenj si Dino Zoff (i dyti në 1973), Gigi Buffon (i dyti në 2006), Oliver Kahn dhe Manuel Neuer nuk ia dolën, duke u renditur vetëm në podium.

## Flick: Barcelona nuk e meritoi eliminimin

Trajneri i Barcelonës, Hansi Flick, shprehu zhgënjimin e tij pas eliminimit nga Liga e Kampionëve. Stretagu gjerman e ka konsideruar rezultatin të padrejtë dhe disa vendime të gjyqtarëve, sipas tij, ishin në favor të "nerazzurrëve". "Jemi të gjithë të zhgënjyer, pasi kemi dhënë kaq shumë në këtë ndeshje", ka thënë Flick. "Disa vendime 50-50 shkuan të gjitha në favor të Interit, por kështu shkojnë gjërat. Jam krenar për ekipin. Mendoj se rezultati është i padrejtë dhe se disa nga vendimet e gjyqtarit ishin shumë të mira, por jo në favorin tonë. Ky është futbolli. Ata e meritonin dhe tifozët e tyre ishin të shkëlqyer, por ne do të kthehemi sezonin e ardhshëm", ka shtuar Flicku, i cili u pyet se çfarë problemi kishte konkretisht në lidhje me gjykimin e gjyqtarit polak Szymon Marciniak. "Nuk dua të flas shumë për këtë. Nuk do të ishte e drejtë ndaj ekipit tim, i cili pati një performancë të shkëlqyer. Nuk dua të flas për gjyqtarin. I thashë atij atë që duhej të thosha".

SVB ENERGY SH.P.K.

Prishtinë, 05.05. 2025

## NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria **„SVB ENERGY" SH.P.K.,** me numër Unik Identifikues 812074532 me adresë: Rr. „20 Qershori" pn, Komuna e Istogut Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.01.2025 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej **3 MW** ZK Sinajë, Komuna e Istogut, Republika e Kosovës.

Shoqëria **„SVB ENERGY" SH.P.K.,** për projektin solar me kapacitet të instaluar prej **3 MW** ZK Sinajë, Komuna e Istogut, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.2763-2/24 dt. 30.05.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Pëlqimin nr. 11-351-241-23 dt. 22.11.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Numri i Lëndës: Nr. 11-351-25250/111 të datës 15.10.2024 për "Ndërtimin e Parkut të Energjisë Solare Fotovoltaike me kapacitet prej 3 MW, ZK Sinajë, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 19361 dt. 20.12.2024 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Deklarimet financiare;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit
- Kontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC)
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: skender_rugova@hotmail.com, arber.lubishtani@elen-ks.com dhe LEGAL-LECENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Elmira Kurpalaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollë së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.

- Sadri Krasniqi nga Xërxa, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë nga klasa 1-8 të SH.F.M.U "Hamëz Thaqi", Xërxe.

- Drelona Krasniqi nga Damjani i Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë nga klasa 1-5 të Sh.F.M.U "Kongresi i Manastirit", Damjan Gjakovë.

- N.T.P. Idi Trade me seli në Prishtinë, shpall të [pavlefshme numrin certifikatën e biznesit me numër fiskal: 600190805.

- Shaip Hodaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore 8 vjeçare në Ortakoll Prizren.

- Betim Katana shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Fitnete Neziri shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Ekrem Rexha" Prizren.

- Gezim Kosova shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Motrat Qiriazi" Prizren.

- Ensar Butuc shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Motrat Qiriazi" Prizren.

- Laokont Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Syla Hodaj B.I. shpall të pavlefshme numrin e biznesit me nr.811142562 të lëshuar nga ATK.

- Leotrim Qevani shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë.

- Ari Mamusha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 10,11,12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Lirigzon Morina nga Senoci i Rahovecit shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 dhe diplomën e shkollës së mesme profesionale "Selajdin Mullaabaz-Mici", Rahovec.

- Fadil Dujaka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Besart Bardhi nga Tropoja e Shqipërisë shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 12 dhe diplomën e lëshuar nga Sh.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

TrafikuUrban

Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullores nr.4417 të datës 04.12.2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës, nenit 8, 10 dhe nenit 12 të Rregullores nr.4074 të datës 31.10.2024 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.1779 i dt. 07.05.2025, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më datë 08.05.2025 shpall:

## K O N K U R S I J A S H T Ë M

**Pozita e punës: Zyrtar për Logjistikë**
**Numri i pozitave:** 1 (një)
**Niveli i Pagës:** X
**Kohëzgjatja e kontratës:** Në afat të pacaktuar
**Kualifikimet:** Shkollim i mesëm
**Përvoja e punës:** 1 vit përvojë pune
**Puna provuese**: 3 muaj

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

**Përgatitja profesionale:**

- Diplomë e shkollës së mesëm;
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

**Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së https://trafikurban-pr.com në vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë, (Aplikacioni duhet të jetë i nënshkruar nga kandidati në të kundërtën nuk do të pranohet)
- CV
- Dëshmi mbi shkollimin;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Certifikatën mbi dënimin penal nga gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com
Konkursi është i hapur nga data **08.05.2025** dhe përfundon më datë **22.05.2025** në ora **24:00.**
**Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave:** Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **23.06.2025**.

**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 08.05.2025

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullores nr.4417 të datës 04.12.2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës, Plotësim Ndryshimit të Rregullores për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës me nr. 341 të dt.31.01.2025, nenit 8,10 dhe nenit 12 të Rregullores nr.4074 të datës 31.10.2024 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.1827 të datës 08.05.2025, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më datë 08.05.2025 shpall:

K O N K U R S I J A S H T Ë M

**Pozita e punës:** Koordinator i Linjave
**Numri i pozitave:** 1 (një);
**Niveli i Pagës:** XIII
**Kohëzgjatja e kontratës:** Në afat të pacaktuar
**Kualifikimet:** Shkollim i mesem
**Përvoja e punës:** 1 vit përvojë pune
**Puna provuese**: 3 muaj

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

**Përgatitja profesionale:**

- Diplomë e shkollës së mesme;
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

**Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së https://trafikurban-pr.com në
- vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë , (Aplikacioni duhet të jetë i nënshkruar nga kandidati në të kundërtën nuk do të pranohet)
- CV
- Dëshmi mbi shkollimin;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Certifikatën mbi dënimin penal nga gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com
Konkursi është i hapur nga data **08.05.2025** dhe përfundon më datë **22.05.2025** në ora **24:00.**
**Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave:** Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **23.06.2025**.

**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**
- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data:
08.05.2025

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullores nr.4417 të datës 04.12.2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës, Plotësim Ndryshimit të Rregullores për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës me nr. 819 të dt.11.03.2025, nenit 8,10 dhe nenit 12 të Rregullores nr.4074 të datës 31.10.2024 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.1778 të datës 07.05.2025, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më datë 08.05.2025 shpall:

K O N K U R S I J A S H T Ë M

**Pozita e punës:** Zyrtar për Marketing
**Numri i pozitave:** 2 (dy);
**Niveli i Pagës:** X
**Kohëzgjatja e kontratës:** Në afat të pacaktuar
**Kualifikimet:** Diplomë Universitare
**Përvoja e punës:** 1 vit përvojë pune
**Puna provuese**: 3 muaj

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

**Përgatitja profesionale:**

- Diplomë Universitare;
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

**Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së https://trafikurban-pr.com në
- vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë , (Aplikacioni duhet të jetë i nënshkruar nga kandidati në të kundërtën nuk do të pranohet)
- CV
- Dëshmi mbi shkollimin;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Certifikatën mbi dënimin penal nga gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com
Konkursi është i hapur nga data **08.05.2025** dhe përfundon më datë **22.05.2025** në ora **24:00.**
**Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave:** Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **23.06.2025**.
**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data:
08.05.2025

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

TrafikuUrban

Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullores nr.4417 të datës 04.12.2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës, Plotësim Ndryshimin me nr.819 i dt. 11.03.2025 të Rregullores për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës, nenit 8, 10 dhe nenit 12 të Rregullores nr.4074 të datës 31.10.2024 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.1781 i dt. 07.05.2025, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më datë 08.05.2025 shpall:

## K O N K U R S I J A S H T Ë M

**Pozita e punës: Arkëtar**
**Numri i pozitave:** 1 (një)
**Niveli i Pagës:** XII
**Kohëzgjatja e kontratës:** Në afat të pacaktuar
**Kualifikimet:** Shkollim i mesëm
**Përvoja e punës:** 1 vit përvojë pune
**Puna provuese**: 3 muaj

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

**Përgatitja profesionale:**

- Diplomë e shkollës së mesme;
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

**Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së https://trafikurban-pr.com në vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë, (Aplikacioni duhet të jetë i nënshkruar nga kandidati në të kundërtën nuk do të pranohet)
- CV;
- Dëshmi mbi shkollimin;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Certifikatën mbi dënimin penal nga gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com
Konkursi është i hapur nga data **08.05.2025** dhe përfundon më datë **22.05.2025** në ora **24:00.**
**Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave:** Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **23.06.2025**.

**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

- Testimi me shkrim - maksimumi 70 pikë
- Intervista - maksimumi 20 pikë
- CV - maksimumi 10 pikë

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 08.05.2025

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

TrafikuUrban

Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullores nr.4417 të datës 04.12.2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës, nenit 8, 10 dhe nenit 12 të Rregullores nr.4074 të datës 31.10.2024 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.1786 të datës 07.05.2025, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më datë 08.05.2025 shpall:

## K O N K U R S I J A S H T Ë M

**Pozita e punës: Zyrtar për Arkivë Qendrore dhe Administratë**
**Numri i pozitave:** 1 (një)
**Niveli i Pagës:** XII
**Kohëzgjatja e kontratës:** Në afat të pacaktuar
**Kualifikimet:** Shkollim i mesëm
**Përvoja e punës:** 1 vit përvojë pune
**Puna provuese**: 3 muaj

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

**Përgatitja profesionale:**

- Diplomë e shkollës së mesme;
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

**Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së https://trafikurban-pr.com në vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë, (Aplikacioni duhet të jetë i nënshkruar nga kandidati në të kundërtën nuk do të pranohet)
- CV;
- Dëshmi mbi shkollimin;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Certifikatën mbi dënimin penal nga gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com
Konkursi është i hapur nga data **08.05.2025** dhe përfundon më datë **22.05.2025** në ora **24:00.**
**Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave:** Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **23.06.2025**.

**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 08.05.2025

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

TrafikuUrban

Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullores nr.4417 të datës 04.12.2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës, nenit 8, 10 dhe nenit 12 të Rregullores nr.4074 të datës 31.10.2024 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.1780 të datës 07.05.2025, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më datë 08.05.2025 shpall:

## K O N K U R S I J A S H T Ë M

**Pozita e punës: Depoist Kryesor**
**Numri i pozitave:** 1 (një)
**Niveli i Pagës:** XI
**Kohëzgjatja e kontratës:** Në afat të pacaktuar
**Kualifikimet:** Përgatitje universitare preferohet nga fushat teknike
**Përvoja e punës:** 2 vit përvojë pune
**Puna provuese**: 3 muaj

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

**Përgatitja profesionale:**

- Përgatitje universitare preferohet nga fushat teknike;
- 2 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

**Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së https://trafikurban-pr.com në vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë, (Aplikacioni duhet të jetë i nënshkruar nga kandidati në të kundërtën nuk do të pranohet)
- CV
- Dëshmi mbi shkollimin;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Certifikatën mbi dënimin penal nga gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com
Konkursi është i hapur nga data **08.05.2025** dhe përfundon më datë **22.05.2025** në ora **24:00.**
**Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave:** Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **23.06.2025**.

**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 08.05.2025

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

TrafikuUrban

Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullores nr.4417 të datës 04.12.2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës, nenit 8, 10 dhe nenit 12 të Rregullores nr.4074 të datës 31.10.2024 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.1782 i dt. 07.05.2025, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më datë 08.05.2025 shpall:

## K O N K U R S I J A S H T Ë M

**Pozita e punës: Riparues i Karrocerisë dhe Autogjyrosjes**
**Numri i pozitave:** 1 (një)
**Niveli i Pagës:** XII
**Kohëzgjatja e kontratës:** Në afat të pacaktuar
**Kualifikimet:** Shkollim profesional nga fusha e autongjyrosjes apo të ngjashme nga shkollimi profesional
**Përvoja e punës:** 1 vit përvojë pune
**Puna provuese**: 3 muaj

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.

**Përgatitja profesionale:**

- Shkollim profesional nga fusha e autongjyrosjes apo të ngjashme nga shkollimi prof.;
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

**Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së https://trafikurban-pr.com në vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë, (Aplikacioni duhet të jetë i nënshkruar nga kandidati në të kundërtën nuk do të pranohet)
- CV
- Dëshmi mbi shkollimin;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Certifikatën mbi dënimin penal nga gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com
Konkursi është i hapur nga data **08.05.2025** dhe përfundon më datë **22.05.2025** në ora **24:00.**
**Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave:** Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **23.06.2025**.

**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 08.05.2025

NPK " Trafiku Urban" SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES
95 g


100% Fresh & Natural
VIDAS
Llatte drink
2%
VIDAS
TAMËL
PRODHUAR ME FINESË DHE DASHURI
2,8%
VIDAS
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
VIDAS
100% i Freskët Natyral
JOGURT
NGA QUMËSHTI I FERMAVE TONA
VIDAS
DHALLË
NGA QUMËSHTI I FERMAVE TONA


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L